

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" ALBANIA ECO POWER" SHPK**

Sot me daten 21/02/2024 (dymijë e njëzet e katër ), unë ortaku themelues :

- **I Z. Rrezart dizdari**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 30 Gusht 1991, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J10830070D.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " ALBANIA ECO POWER" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " ALBANIA ECO POWER" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Durrës,Shkozet,truall me zonë kadastrale 8515 ,numër pasurie 1/206,vol 8,fq.90 .

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Tregtim import-eksport pakice shumice te paneleve voltaike per cati, tarraca dhe cdo lloj terreni. Impjant fotovoltaik dhe Invertera. Panele fotovoltaik te lidhura me rrjetin dhe rrjetin elektrik per shtepi private, biznese, ndertesa, fabrika, punishte, stalla, kapanone, ferma. Bateri, invertera, qeliza fotovoltaike, UPS, konektore, rregullatore, struktura mbajtese, aksesore etj.Prodhim, tregtim dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe prodhimeve kundra zjarrit, tabelave shënuese kundër aksidenteve dhe sinjalistikë. Përpunimi lëngjeve dhe bombulave kundra zjarrit. Kurse për mbrojtjen kundra zjarrit dhe mbrojtje individuale. Tregti te gazit me shumice dhe pakice.Larje dhe pastrim te mjeteve motorrike. Tregti të gazit, naftës, lëndëve djegëse, shitja e bombolave të gazit të të gjitha dimensioneve dhe për të gjitha përdorimet me shumicë dhe pakicë. Tregtimi dhe rimbushja e bombolave të gazit. Tregtimi, transformimi, transporti i gazit të lëngshëm të naftës (GLN), gazit propan, gazit metan, pjesëve përbërëse ose përzierësve të tyre si dhe të gjitha llojeve të tjera të



gazrave teknike për përdorim industrial dhe civil. Tregti, import, eksport automjetesh dhe dhënie automjetesh me qera.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "ALBANIA ECO POWER" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

**1. RREZART DIZDARI zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

**NENI 6**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë

1- **Z. RREZART DIZDARI**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"ALBANIA ECO POWER" SH.P.K**  
**RREZART DIZDARI**

Rrezart Dizdari

